



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGISJË

DRAFT

**RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR TË
LICENSUARIT NË SEKTORIN E ENERGISJË ELEKTRIKE**

Neni 1

Autoriteti

Rregullorja për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të gjithë të licensuarit e tregut të energjisë elektrike nga Enti Rregullator i Energjise, është hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”,

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat për përlogaritjen e pagesave rregullatore/të rregullimit për të gjithë të licensuarit në tregun e energjisë elektrike si një nga burimet kryesore të financimit të ERE-s, me qëllim mbulimin e kostove të aktivitetit të rregullimit.

Neni 3

Objektivi

Objektivi i kësaj rregulloreje të llogaritjes së pagesave të rregullimit është të përcaktojë pagesa rregullimi të veçanta për të gjithë të licensuarit në aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, operimit të sistemeve të mbyllura të shpërndarjes, furnizimit, tregëtimit dhe operimit të tregut të energjisë elektrike.

Neni 4

Termet e përdorur në këtë rregullore

Termet e përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin si më poshtë:

1. **Pagesa e rregullatore** – pagesa vjetore që të gjitha shoqëritë e licensuara në sektorin e energjisë elektrike paguajnë për llogari të ERE-S për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore.

2. **Të Licensuar** – shoqëri që janë licensuar nga ERE për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, transmetimit të energjisë elektrike, shpërndarjes/ furnizimit të energjisë elektrike si dhe tregëtimit të energjisë elektrike, operimit të sistemeve të mbyllura të shpërndarjes, Operimit të Tregut të energjisë elektrike.
3. **Të ardhurat** – nënkuptojnë të ardhurat vjetore të deklaruara në pasqyrat financiare të audituara referuar Standarteve të Kontabilitetit në fuqi.

Neni 5

Rregulla të përgjithshme dhe parime bazë

1. Kjo Rregullore është konceptuar konform nenit 17 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” ku parashikohet se:
 - a. Burimet financiare të ERE-së përbëhen nga pagesat rregullatore, të vendosura nga ajo vetë për të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike, dhe nga pagesat e licensave.
 - b. ERE-ja mban llogari të plota për shpenzimet e kryera, në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi kontabilitetin.
2. Pagesa e rregullimit, në zbatim të pikës 52 të nenit 3 të Ligjit 43/2015 llogaritet dhe mbledhet mbi baza vjetore për çdo shoqëri të licensuar, pavarësisht faktit nëse në momentin e llogaritjes së kësaj pagese kompania nuk e ka filluar aktivitetin për të cilin është licensuar.
 - a. Pagesa duhet të jetë në përpjestim të drejtë me të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licensuar.
 - b. Të licensuarit në zbatim të neneve 45 e 46 të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe të kushteve të licensës depozitojnë në ERE deri me datë 31 Janar të vitit pasardhës pasqyra të plota për vitin e mëparshëm ushtrimor e më tej deri në datë 30 Qershor, kopje të audituara të pasqyrave financiare të periudhës së mëparshme nga ku rezulton informacioni mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i licensuar që do të përdoren në llogaritjen e pagesave të rregullimit.
 - c. Pagesat e rregullimit duhet të miratohen deri në 15 Dhjetor të vitit aktual.

Neni 6

Përcaktimi i pagesës rregullatore për të licencuarit në sektorin e energjisë

1. Pagesat e rregullimit do të llogariten bazuar në peshën specifike që zënë të ardhurat e realizuara në vitin paraardhës nga aktiviteti I cdo të licensuari ndaj totalit të të ardhurave të sektorit të energjisë elektrike.
2. Pagesa e rregullimit për secilin të licensuar është e barabartë me produktin e peshës specifike të llogaritur sipas pikës 1 të këtij neni me vleftën për t'u shpërndarë, buxhetin e ERE-s (pasi të jenë zbritur pagesat fikse nga licensimi) të percaktuar sipas pikës 1 të nenit 17 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
3. Për shoqëritë e licensuara në aktivitetin e prodhimit, furnizimit dhe tregëtimit të energjisë elektrike që në vitin paraardhës nuk kanë patur aktivitet, pagesa e rregullimit do të jete një shume fikse.
4. Në rastet kur ndonjë shoqëri e licensuar nuk ka paraqitur pasqyrat financiare, siç parashikon neni 46 i Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, atehere ERE do te përllorjrite këtë pagesë mbi bazën e vlerësimeve nga të dhëna të marra nga Publikime Zyrtare

Neni 7

Korrigjimi

ERE me paraqitjen e një kërkesë nga të licensuarit në rast të pasaktësive të llogaritjes në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti i licensuar, rillogarit dhe korrigjon pagesën rregullatore të vitit aktual në pagesën rregullatore te vitit pasardhës.

Neni 8

Njoftimi

1. ERE pasi përcakton pagesat rregullatore njofton të licensuarin për vlerën, afatet e pagesës për vitin ushtrimor, vëndin e kryerjes së këtyre pagesave dhe penalitetet në rast se kjo pagesë nuk kryhet në kohë.
2. Pagesat rregullatore depozitohen nga ERE në një llogari të veçantë , të hapur në një nga bankat që operojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi

Neni 9
Penalitetet

1. Në rast se i licencuari nuk bën pagesën rregullatore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, ndaj tij zbatohen sanksione në përputhje me nenin 107 të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
2. Refuzimi i paraqitjes së pasqyrave financiare në kohë ose dërgimi me vonese i tyre perbëjnë kundravajtje administrative dhe ndëshkohen sipas pikës 1 (b) nenit 107 të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
3. Në rast se i licensuari nuk përmbush detyrimin për kryerjen e pagesës rregullatore edhe pas masës së marrë sipas pikës 1 dhe pikës 2 të këtij neni, atëherë ndaj tij Bordi mund të fillojë procedurat për heqjen e licensës, siç përcaktuar në pikën 1 (c) të nenit 42 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

Neni 10
Dispozita përfundimtare

Rregullorja për përcaktimin e pagesave rregullatore për të gjithë të licensuarit e tregut të energjisë elektrike nga Enti Rregullator i Energjisë, u miratua nga Bordi i ERE-s me Vendimin nr ____, datë. ____/____/____